



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 08 .
Prishtinë, më 20.04.2015, në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Rustem Berisha, Çerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Saša Milosavljević, Jasmina Živković, Milka Vuletić dhe Slavko Simić.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi, përfaqësues nga UNMIK-u Vlora Nushi, përfaqësues nga EUSR/EU Blerta Bejtullahu, përfaqësues të TV - 21, TV- Rokum, RTK-21, Klan, përfaqësues të Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, Zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Agim Çeku, zëvendëskryetar i parë i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i ministrit për strukturën e gjyqëtarëve dhe prokurorëve në sistemin gjyqësor në bazë të dialogut Prishtinë-Beograd.**

I ftuar: Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi.

- 3. Të ndryshme**

1. Miratimi i rendit të ditës

Agim Çeku– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Raportimi i ministrit për strukturën e gjyqëtarëve dhe prokurorëve në sistemin gjyqësor në bazë të dialogut Prishtinë-Beograd. I ftuar: Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi.

Agim Çeku – zëvendëskryetar i parë i komisionit, fillimisht shprehu mirëseardhje anëtarëit të ri zot, Rrustem Berisha. Konsideron se do kemi çasje të kordinuar dhe bashkëpunim korrekt në Komision.

Njëherit, i njoftoi anëtarët e komisionit se ministri z.Hajredin Kuçi ka kërkuar falje për mospjesëmarrjen e tij në takim të Komisionit, nga se ka pas angazhime të natyrës së veçant, në vend të tij ka dërguar zëvendëministritin z. Lirak Qelaj. Paprapakisht, ministri i Drejtësisë ka dërguar raportin me shkrim anëtarëve të Komisionit, me të dhëna për funksionimin e strukturës së gjyqëtarëve dhe prokurorëve në sistemin Gjyqësor, në bazë të dialogut Prishtinë – Beograd.

Lidhur me marrëveshjen e arritur përmes dialogut Prishtin- Beograd, ka pas rreagime si në Kuvend ashtu edhe në Komision nga ana e deputetëve të komunitetit jo shumicë, me arsye të mos përfshirjes së tyre me këtë marrëveshje. Në kuadër të këtyre shqetësimeve, Komisioni ka marrë qëndrim të ftohet ministri i Ministrisë së Drejtësisë, për të prezentuar raportin e ministrisë përkatëse.

Zëvendëskryesuesi - fjalën ia dha zëvendësministrit, që të raportoj për marrëveshjen dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Zëvendësministri - Lirak Qelaj – duke iu referuar ftesës së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, tha se është i gatshëm të elaburojë lidhur me marrëveshjen e drejtësisë të arritur me 10 shkurt 2015 , e cila parasheh zbatimin e plotë të legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe funksionimin e sistemi unik të drejtësisë, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshir edhe pjesën e veriut.

Në kuadër të marrëveshjes, themelimi i Gjykatës Themelore dhe zyrës së Prokurorisë Themelore në regjionin e Mitrovicës, që përfshin shtatë komuna, është në përputhshmëri të plotë me ligjin për Gjykatat. Sistemi unik i drejtësisë dhe zbatueshmëria e legjislacionit, siguron që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe pjesëtarët e cilit do komunitet, të kan të drejtë dhe qasje të barabartë në sistemin e drejtësisë.

Në muajin shtator të vitit 2013, palët janë pajtuar që ti jepet fund strukturave paralele të drejtësisë, mirëpo ky proces ende nuk është funksional, për këtë çështje kërkohet të ketë vuillnet politik nga autriteti Serb.

Theksoi se hapat e parë konkret për integrimin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve serb, ka rezultuar me rastine e shpalljes së konkursit për 48 gjyqëtarë dhe 15 prokurorë, të datuar prej 25 marsit i cili do të jetë i hapur deri më 25 maj 2015.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, kanë marr hapa konkret në plotësimin e vendeve të punës, si për gjyqëtar dhe prokuror ashtu edhe për stafin mbështetës, nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

Në të gjitha nivelet e gjyqësorit, nga gjithësejt 312 gjyqëtar, gjashtë gjyqëtar janë nga komuniteti serb, nëntë nga komuniteti boshnjak, një nga komuniteti turk dhe dy nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian. Prej 1525 shërbyesve civil, në gjyqësor, 112 janë nga komuniteti serb, 20 nga komuniteti boshnjak, 3 nga komuniteti goran dhe 11 nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian.

Në kuadër të nivelit të prokurorisë, prej 139 prokurorëve, dy janë nga komuniteti serb, tre nga komuniteti boshnjak dhe një nga komuniteti turk. Prej 434 shërbyeve civil, katër janë nga komuniteti serb, tetë nga komuniteti boshnjak, pesë nga komuniteti turk, një nga komuniteti goran dhe një nga komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian.

Zëvendëskryesuesi - hapi depat, me qëllim që anëtarët e komisionit të parashtrojnë pyetje zëvendësministrit.

Veton Berisha - fillimisht ngriti çështjen e zhdukjes së të riut të komunitetit të tij, Zija Nuka. Me këtë rast bën thirrje ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me ministrin e Punëve të Brendshme, në gjetjen e mekanizmave në zbardhjen e rastit sa më par. Për situatën e krijuar, sot nuk vijnë mësimin më shumë se gjysma e fëmijëve të komunitetit egjiptian.

Bazuar në marrëveshjen e arritur në Bruksel, ai ka ngritur shqetësimin e tij si në Kuvend poashtu edhe në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Në kuadër të strukturës së gjyqëtarëve dhe prokurorëve në sistemin Gjyqësor, të bazuar në dialogun Prishtinë – Beograd, konsideron se ka shkelje Kushtetutuese të Republikës së Kosovës.

Me këtë marrëveshje, të drejtë për të konkurruar si gjyqëtarë dhe prokurorë në pjesën veriore të Mitrovicës, kanë vetëm pjesëtarët e komunitetit shqiptar dhe atij serb ndërsa kjo e drejtë nuk është rezervuar për komunitetet tjera, para së gjithash për komunitetin egjiptian, të cilit ai i përket.

Ai shpalosi disa raste të shkeljes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke filluar prej preambulës paragrafi 2, Kapitulli III- që ka të bëjë me të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarët e tyre, përfshirë neni 57 dhe 58. Ndalet edhe në nenin 3- ku bëhet fjalë për barazin para ligjit, nenin 31 - e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Foli edhe për shkeljen e një mori ligjeve bazike të Republikës së Kosovës, siç janë Ligji për mbrojtjen e të Drejtave dhe Interesave të Komuniteteve, Ligji kundër Diskriminimit, Ligji për Gjykatat. Diskutoi edhe për shkeljen e konventave ku të njejtat janë të inkuoruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sipas mendimit të tij shkelje ka edhe në raportin e ministrisë së Drejtësisë, si shembull mur një paragraf, ku shkruan, një shërbyes civil nga ‘komuniteti RAE’. Ai kërkoi që emërtimi në fjalë të ndryshohet dhe të trajtohen të ndara komunitetet: Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Ai propozoi që ministria e Drejtësisë të rishikojë edhe një herë përmbajtjen e marrëveshjes, me arsye të ketë gjykim të paanshëm dhe avansimit të drejtë për të gjitha komunitetet tjera, të cilët jetojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Në fund komentoj, se mbi 300 përfaqësues të komunitetit egjiptian kanë përgaditje të nivelit të mesëm dhe të lartë. Mund të thuhet se një përqindje shumë e vogël prej tyre janë të punësuar si në sektorin e drejtësisë ashtu edhe në sektorin e shërbimit civil. Kjo problematikë paraqet ngarkesë të madhe për komunitetin tonë. Ai konsideron se kjo çështje është anti kushtetuese nga se nuk respektohet kuota për komunitetin tone, e cila parashihet edhe me Ligjin për Shërbyes Civil.

Cerim Bajrami – ishte i mendimit se marrëveshja për strukturën e gjyqëtarëve dhe prokurorëve të sistemit Gjyqësor, në bazë të dialogut Prishtinë – Beograd, është jo Kushtetuese. Shprehu brengën e tij se në bazë të Marrëveshjes dhe informatave që kemi nga Mitrovica e Veriut, asnjë pjesëtarë i komunitetit Boshnjak nuk ka konkurruar në pozitën e gjyqtarit apo të prokurorit, nga se është kriju një pasiguri për komunitetin tonë.

Sipas marrëveshjes, në gjykatën Themelore në rajonin e Mitrovicës janë caktu nëntë gjyqtarë shqiptarë dhe nëntë serbë, ndërsa në Prokurorinë Themelore -pesë gjyqtarë serbë dhe katër shqiptar. Konkretisht. Marrëveshja në fjalë, sjellë mesazh të gabuar për komunitetin jo – shumicë, nga se me Kushtetutë dhe Ligjet e Kosovës ua garantohet e drejta të integrohen në sistemin gjyqësor.

Është e një rëndësie të veçant nevoja e rishikimit të legjislacionit, me qëlim të ndërmeren veprime të duhura dhe të rezervohet nga një vend për komunitetin jo-shqiptar dhe jo-serb. Në të kundërtën, kjo shemë është e paparanueshme për komunitetin tonë.

Danush Ademi – ai shprehu keqardhje për familjen me rastin e zhdukjes së djalit të tyre, Zija Nuka. Kërkesa e tij ishte, që institucionet e drejtësisë të ndërmarin veprime të duhura në zbardhjen e këtij rasti.

Mendon, se u ngritën shumë çështje lidhur me marrëveshjen dhe nuk do ti përsërit të njejtat. Ai u përqëndrua në çështjen lidhur me konkursin, ku me kuotë kërkohet përvoja 5 apo 10 vjeçare. Gjeqësish, pjesëtarët e komunitetit romë nuk kanë pas rasisht të punojnë më herët dhe ta përfitojnë këtë përvojë. Për zëvendësministrin parashtrojë pyetje, sipas marrëveshjes së drejtësisë, si është e rregulluar funksionimi i përzgjedhjes të komunitetit romë?

Zëvendësministri – shprehu mendimin e tij, se kur bëhet fjalë për personin e zhdukur Zija Nuka, me përgjegjësi të plotë institucionet janë në përpjeke të vazhdueshme në gjetjen e peronit të humbur.

Në dhënjen e përgjigjeve të parashtruara nga anëtarët e komisionit, së pari u përqëndrua në Marrëveshjen e Drejtësisë të arritur në 10 shkurt 2015, ku fillon faza e integritit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të komunitetit Serbë, në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Theksoi se kjo marrëveshje e cila ka dalë si rezultat i dialogut, adresohet për përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për pjestarët e cilit do komunitet, kudo që ata jetojnë dhe veprojnë në Kosovë.

Gjithashtu, dha sqarim se një numër i konsideruar i vendeve ka mbetur të paplotësuar në strukturat gjyqësore dhe prokuroriale në veri të Mitrovicës. Në sektorin e drejtësisë, konkursi ka mbet i hapur për vendet e pa plotsuara, andaj nuk përjashtohet mundësia që në

të ardhmen të aplikojë edhe përfaqësuesit e komuniteteve tjera, gjegjësisht kjo vlen edhe për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

Zëvendëskryesuesi, përmes marrëveshjes së drejtësisë, shihet se do të vendosen objektivat e zbatimit të plotë të legjislacionit të Republikës së Kosovës, përsfshirë edhe pjesën veriore. Pra, kjo dëshmon se të gjitha instiucionet e Kosovës, kanë për qëllim të ken një sitem unik të drejtësisë.

3, Të ndryshme

Veton Berisha- tha se jemi të vonuar në realizimin e detyrave që dalin nga Plani i Punës për vitin 2015. Propozimi i tij ishte që komisioni të takohet në përbërje të plotë dhe të caktohen grupet punuese, lidhur me monitorimin e Ligjeve.

Pas diskutimeve të anëtarëve, Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, muar qëndrim që javën e ardhshme të mbahet takimi me rend dite: caktimi i grupeve punuese për monitorim të ligjeve, bazuar në Planin e punës për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Agim Çeku